

L I G J
Nr.8082, datë 7.3.1996

PËR PAGAT E PROKURORISË SË APELIT USHTARAK

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Pagat e Prokurorisë së Apelit Ushtarak të jenë të njëjta me ato të Prokuroris së Apelit Civil, për funksionet prokuror i apelit, zëvendësprokuror dhe prokuror.

Neni 2

Pagat sipas paragrafit të tretë, të pasqyrës nr.3 bashkëlidhur ligjit nr.7800 datë 2.3.1994 “Për pagat e gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve efektivë, prokurorëve dhe hetuesve”, për Prokurorin e Apelit Ushtrak, shfuqizohen.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij nga data 1 mars 1996.

Shpallur me dekretin nr.1417, datë 20.3.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha